

URDHËR
Nr. 433, datë 21.4.2026

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 292, DATË 17.3.2026, “PËR
DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME
PATOGENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E
FRANCËS”**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës, në pikën 3, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 292, datë 17.3.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDESMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri